



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2022-13
KSC-CC-2022-14

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland, Kryegjykatës
Gjykatës Roumen Nenkov
Gjykatëse Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 13 qershor 2022

Gjuha: Anglishte

Titulli i lëndës: Kërkesë Referuese e Jakup Krasniqit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët
Kërkesë Referuese e Kadri Veselit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit mbi Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën Referuese të Jakup Krasniqit në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët dhe Kërkesën Referuese të Kadri Veselit në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit për Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara

Parashtruesve

Jakup Krasniqi

Kadri Veseli

Hashim Thaçi

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

E përbëra nga

Vidar Stensland, kryegjykatës

Roumen Nenkov, gjykatës

Romina Inkuti, gjykatëse

pas diskutimit pa prani fizike, jep vendimin e mëposhtëm

I. PROCEDURA

A. KËRKESAT REFERUESE

1. Më 28 shkurt 2022, z. Jakup Krasniqi dhe z. Kadri Veseli ("parashtruesit") i dorëzuan Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma")¹ kërkesa referuese në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") dhe nenit 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji").² Z. Krasniqi ("parashtruesi i parë") përfaqësuar nga znj. Venkatesvari Alagenda dhe z. Aidan Elis, dhe z. Veseli ("parashtruesi i dytë"), përfaqësuar nga z. Ben Emerson dhe z. Endrju Strong.

2. Në kërkesat e tyre referuese, parashtruesit paraqitën ankesë për shkelje të të drejtave themelore në procesin penal kundër tyre, para Dhomave të Specializuara

¹ Në lidhje me caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), shih KSC-CC-2022-13, F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 1 mars 2022; KSC-CC-2022-14, F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 1 mars 2022.

² KSC-CC-2022-13, F00001, Kërkesë Referuese e Mbrojtjes së Krasniqit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, publike, 28 shkurt 2022 ("Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Parë"), me Shtojcën 1, publike; KSC-CC-2022-14, F00001, Kërkesë Referuese e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara", publik, 28 shkurt 2022 ("Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë"), me Shtojcën 1, publike.

(“DHS”). Konkretisht ata argumentojnë se ndjekja penale e tyre në bazë të disa akuzave të ngritura kundër tyre shkel të drejtat themelore të tyre të nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”). Parashtruesi i dytë gjithashtu paraqet ankesë se është kryer shkelje e të drejtave të tij të garantuara prej neneve 19, 24 dhe 55 të Kushtetutës, nenit 14 të Konventës dhe neneve 15 dhe 26 të Konventës Ndërkombëtare për Të Drejtat Civile dhe Politike (“KNDCP”).³

B. MOCIONET PËR BASHKIM

3. Më 10 mars 2022, z. Hashim Thaçi, i cili gjithashtu i kishte paraqitur kërkesë referuese Dhomës,⁴ dorëzoi dy mocione për bashkim, një për bashkim me kërkesën referuese të parashtruesit të parë, dhe tjetrin për bashkim me kërkesën referuese të parashtruesit të dytë.⁵ Në mocionet për bashkim, z. Thaçi deklaronte se “pajtohet me argumentet e paraqitura në [dy kërkesat referuese] [...]”, dhe se ai “[...] u bashkohet [dy kërkesave referuese], dhe mbështet kërkesën për mjet juridik të paraqitur në to”.⁶

C. PARASHTRIMET ME SHKRIM

³ Kërkesa Referuese e z. Krasniqi, para 1-2, 16, 76; shih KSC-CC-2022-13, F00005, Vendim për Parashtrime të Tjera, publik, 15 mars 2022, para. 3. Kërkesa Referuese e z. Veseli, para 7, 19, 22, 24, 31, 33, 48, 64, 66, 70-72, 88, 91; shih KSC-CC-2022-14, F00005, Vendim për Parashtrime të Tjera, publik, 15 mars 2022, para 3-5.

⁴ KSC-CC-2022-15, F00001, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e Të Drejtave Themelore të z. Thaçi për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsytuar, publik, 28 shkurt 2022.

⁵ KSC-CC-2022-13, F00003, Mocion i Thaçit për Bashkim me Kërkesën Referuese të Mbrojtjes së Krasniqit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, publik, 10 March 2022 (“Mocioni për Bashkim me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Parë”); KSC-CC-2022-14, F00003, Mocion i Thaçit për Bashkim me Kërkesën Referuese të Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 10 mars 2022 (“Mocioni për Bashkim me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Dytë”).

⁶ Mocioni për Bashkim me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Parë, para 3, 5; Mocioni për Bashkim me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Dytë, para 3-4.

4. Më 30 mars dhe 8 prill 2022, ZPS-ja dhe parashtruesit dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim lidhur me kërkesat referuese,⁷ ku trajtonin pyetjet që u ishin drejtuar nga Dhoma sipas rregullës 15(2) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“Rregullorja e Punës”).⁸

D. SHQYRTIMI I KËRKESAVE REFERUESE

5. Duke marrë parasysh, ngjashmërinë e kërkesave referuese të parashtruesve, në interes të efikasitetit procedural, Dhoma vendos t’i shqyrtojë ato bashkërisht në bazë të rregullës 15(6) të Rregullores së Punës.

6. Dhoma do t’i shqyrtojë kërkesat referuese duke u bazuar në vetë kërkesat referuese dhe në parashtrimet e lartpërmendura me shkrim të ZPS-së dhe të parashtruesve. Dhoma do t’u referohet fakteve të çështjes dhe argumenteve të ZPS-së dhe të parashtruesve për aq sa kanë lidhje me këtë shqyrtim të kërkesave referuese prej Dhomës.

II. FAKTET

⁷ KSC-CC-2022-13, F00006, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Vendimit për Parashtrime të Tjera në lidhje me Kërkesën Referuese të Krasniqit (KSC-CC-2022-13/F00005), publike, 30 mars 2022, me Shtojcën 1, publike (“Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Parë”); KSC-CC-2022-14, F00006, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Vendimit për Parashtrime të Tjera në lidhje me Kërkesën Referuese të Veselit (KSC-CC-2022-14/F00005), publike, 30 mars 2022, me Shtojcën 1, publike (“Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Dytë”); KSC-CC-2022-13, F00009, Parashtrime të Mëtejshme të Mbrojtjes së Krasniqit në lidhje me Kërkesën Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, publik, 8 prill 2022 (“Parashtrimet e Parashtruesit të Parë”); KSC-CC-2022-14, F00008, Parashtrime të Mbrojtjes së Veselit mbi Vendimin për Parashtrime të Tjera në lidhje me Kërkesën Referuese të Veselit (KSC-CC-2022-14-F00005), publike, 8 prill 2022, me Shtojcën 1, publike (“Parashtrimet e Parashtruesit të Dytë”).

⁸ KSC-CC-2022-13, F00005, Vendim për Parashtrime të Tjera, publik, 15 mars 2022; KSC-CC-2022-14, F00005, Vendim për Parashtrime të Tjera, publik, 15 mars 2022. Lidhur me zgjatjen e afatit për dorëzimin e parashtrimeve prej parashtruesve, shih KSC-CC-2022-13, F00008, Vendim në lidhje me Afatin për Dorëzimin e Parashtrimeve prej Parashtruesit, publik, 1 prill 2022; KSC-CC-2022-14, F00007, Vendim në lidhje me Afatin për Dorëzimin e Parashtrimeve prej Parashtruesit, publik, 1 prill 2022.

A. AKTAKUZA

7. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër parashtruesve ku ata akuzoheshin për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit që pretendohej se ishin kryer midis së paku marsit 1998 dhe shtatorit 1999 në Kosovë dhe në pjesë të Shqipërisë veriore.⁹ Ndër akuzat përfshihen, ndalimi arbitrar si krim lufte dhe zhdukja me forcë e personave si krim kundër njerëzimit, që pretendohej se ishin kryer përmes pjesëmarrjes së parashtruesve në një ndërmarrje kriminale të përbashkët (“NKP”), në formën bazë dhe të zgjeruar të saj.¹⁰

1. E drejta zakonore ndërkombëtare

8. Në lidhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare (“DZN”), Gjykatësi i Procedurës Paraprake arriti në përfundimin se në pajtim me nenin 3(2)(d) dhe (3), dhe nenin 12 të Ligjit, DHS-ja zbatonte DZN-në në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara.¹¹

2. Ndalimi arbitrar dhe zhdukja me forcë

9. Lidhur me krimin e zhdukjes me forcë të personave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ai përmendej shprehimisht në nenin 13(1)(i) të Ligjit si krim kundër njerëzimit në bazë të DZN-së.¹² Për ndalimin arbitrar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake theksoi se nuk përmendej shprehimisht në nenin 14(1)(c) si krim lufte në bazë të DZN-së.¹³ Sidoqoftë, ai krim ekzistonte sipas DZN-së në periudhën përkatëse.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, publik, 26 tetor 2020 (version i redaktuar publik u protokollua më 30 nëntor 2020) (“Vendimi i Konfirmimit”), para 15, 39, 41-42, 127, 129. Aktakuza e ndryshuar e konfirmuar më tej më 29 prill 2022, shih KSC-BC-2020-06, F00789/A05, version i redaktuar publik i Aktakuzës së Ndryshuar, publik, 29 prill 2022.

¹⁰ Vendimi i Konfirmimit, para 15, 104, 138, 231, 418, 436, 451, 474-475, 478, 521(a), shih gjithashtu para 105-115, 139-230, 419-435, 439-440, 452-463, 468-473, 476-477.

¹¹ Vendimi i Konfirmimit, para. 22.

¹² Vendimi i Konfirmimit, para 23-24, shih gjithashtu para 418, 436.

¹³ Vendimi i Konfirmimit, para. 33.

Për këtë arsye, DHS-ja mund të ushtronte juridiksion në lidhje me ndalimin arbitrar si krim lufte, brenda kuptimit të nenit 14(1)(c) të Ligjit.¹⁴

3. Ndërmarrja Kriminale e Përbashkët

10. Gjykatësi i Procedurës Paraprake iu referua nenit 16(1)(a) të Ligjit në të cilin “kryerja” përcaktohet si një ndër format e përgjegjesisë penale individuale.¹⁵ Më tej, ai konstatoi se ekzistonte dyshim i bazuar mirë se parashtruesit si anëtarë të NKP-së në formën bazë dhe si alternativë në formën e zgjeruar të saj,¹⁶ i kishin kryer krimet e pretenduara, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit.¹⁷

11. Pas konfirmimit të aktakuzës prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar më 30 tetor 2020.¹⁸ Më 4 nëntor 2021, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e korrigjuar dhe më 3 shtator 2021, dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të korrigjuar më tej.¹⁹

B. KUNDËRSHTIMET E PARASHTRUESVE NDAJ JURIDIKSIONIT TË DHS-SË

12. Më 15 mars 2021, parashtruesit i dorëzuan Gjykatësit të Procedurës Paraprake mocione paraprake ku ngrinin kundërshtime ndaj juridiksionit të DHS-së për

¹⁴ Vendimi i Konfirmimit, para 33, 37-38, shih edhe para 93-97.

¹⁵ Vendimi i Konfirmimit, para. 25.

¹⁶ Vendimi i Konfirmimit, para. 478.

¹⁷ Vendimi i Konfirmimit, para. 474.

¹⁸ KSC-BC-2020-06, F00034/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁹ KSC-BC-2020-06, F00045/RED, Versioni i Redaktuar Publik i ‘Parashtrimit të Versioneve të Korrigjuara dhe të Redaktuara Publike të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të’, parashtrimi i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00045 me datë 4 nëntor 2020, publik, 18 nëntor 2020 (originali u dorëzua më 4 nëntor 2020); F00455/RED, Versioni i redaktuar publik i ‘Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesës për Ndryshim në pajtim me Rregullën 90(1)(b)’, KSC-BC-2020-06/F00455, me datë 3 shtator 2021, publik, 8 shtator 2021, me Shtojcën 1, publike (origjinali u protokollua më 3 shtator 2021); F00647/RED, Parashtrim prej Prokurorisë i versioneve me më pak redakte të Aktakuzës dhe Përmbledhjes sipas Rregullës 86(3)(b), publik, 28 janar 2022, me Shtojcat 1-2, konfidenciale (origjinali protokolluar më 17 janar 2022).

gjykimin në lidhje me akuzat e ngritura kundër tyre.²⁰ Konkretisht, ata argumentonin ndër të tjera se DHS-ja nuk kishte juridiksion në lidhje me NKP-në.²¹ Parashtruesi i dytë gjithashtu pretendoi se DHS-ja nuk kishte juridiksion në lidhje me ndalimin arbitrar dhe zhdukjen me forcë.²² Ai argumentoi se akuzat në lidhje me këto vepra penale, edhe nëse bazoheshin në DZN, ishin jashtë juridiksionit të DHS-së.²³ Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë mocionet paraprake të parashtruesve.²⁴ Më 27 gusht 2021, parashtruesit apeluan vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.²⁵

1. E drejta zakonore ndërkombëtare

13. Parashtruesi i dytë argumentoi se në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara, legjislacioni në fuqi kishte qenë Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e vitit 1974 (“Kushtetuta e RSFJ-së”), si edhe Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 (“Kodi Penal i RSFJ-së”).²⁶ Kushtetuta e RSFJ-së me anë të neneve të saj 181 dhe 210 ndalonte zbatimin e drejtpërdrejtë të DZN-së. Për më tepër, edhe sipas neneve 19(1) dhe 55 të Kushtetutës së Kosovës, DZN-ja nuk kishte efekt të drejtpërdrejtë.²⁷

²⁰ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Parë, para. 9, përmendet KSC-BC-2020-06, F00220, Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Krasniqit lidhur me Juridiksionin, publik, 15 mars 2021, me Shtojcën 1, publike (“Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Parë”); Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para 17, 65, 74, citohet KSC-BC-2020-06, F00223, Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Kadri Veselit për Kundërshtimin e Juridiksionit të DHSK-së, publik, 15 mars 2021 (“Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Dytë”).

²¹ Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Parë, para 1, 70; Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Dytë, para 33-34, 39(b), 54, 91-92, 163(b).

²² Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Dytë, para 37-38, 39(b), 54, 131, 163(b).

²³ Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Dytë, para 31, 37, 39(b), 40, 53, 91, 163(b).

²⁴ KSC-BC-2020-06, F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 22 korrik 2021 (“Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake”), para. 214.

²⁵ KSC-BC-2020-06, IA009, F00013, Apel i Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 27 gusht 2021 (“Apeli i Parashtruesit të Parë”), me Shtojcën 1, publike; KSC-BC-2020-06, IA009, F00010, Apel i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 27 gusht 2021 (“Apeli i Parashtruesit të Dytë”), me Shtojcat 1-5, publike.

²⁶ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 3-5; Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Dytë, para. 7.

²⁷ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 4, 20, 23, 25; Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Dytë, para 7, 12, 43, 46.

Gjithashtu, ai argumentonte se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e kishte shqyrtuar këtë pikë duke iu referuar vetëm nenit 7 të Konventës. Megjithatë, neni 7 nuk mund të përcaktonte zbatueshmërinë e DZN-së në rendin juridik ndërkombëtar, duke e shpërfillur ndalimin e zbatimit të drejtpërdrejtë të DZN-së që përmbante Kushtetuta e RSFJ-së dhe Kushtetuta e Kosovës.²⁸

14. Gjithashtu, parashtruesi i dytë argumentoi se juridiksioni i DHS-së kufizohej vetëm në sjellje që penalizohej në Kodin Penal të RSFJ-së i cili ishte në fuqi më 1998. DHS-ja mund të zbatonte dispozita të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara vetëm nëse ato kishin një dispozitë korresponduese në Kodin Penal të RSFJ-së, ose nëse ato ishin më të favorshme në lidhje me të akuzuarin se dispozitat penale vendore. Edhe sikur DHS-ja mund të zbatonte DZN-në, kjo përbënte shkelje të parimit *lex mitior* sipas nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës, në qoftë se ekzistonin dispozita ligjore të tjera më të favorshme ndaj të akuzuarve, si ato në lidhje me format e përgjegjësisë penale.²⁹

15. Në lidhje me DZN-në, parashtruesi i dytë iu referua jurisprudencës së gjykatave serbe dhe konstatoi se korniza kushtetuese në fuqi më 1998 nuk lejonte efektin e drejtpërdrejtë të DZN-së dhe se në fuqi ishte Kodi Penal i RSFJ-së.³⁰ Më tej argumentohej se një individ nën ndjekje penale në Serbi për të njëjtën sjellje, nuk mund të gjykohej në bazë të DZN-së. Sidoqoftë për parashtruesin e dytë u zbatua një sistem i ndryshëm ligjor, vetëm për shkak të faktit se ZPS-ja e procedoi penalisht para DHS-së. Kjo rezultoi në ndryshim të pajustificuar të zbatimit të parimit të ligjshmërisë sipas Kushtetutës së RSFJ-së, Kushtetutës së Kosovës, Konventës dhe KNDCP-së, në shkelje

²⁸ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 26, 31-34, 39.

²⁹ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 3, 20(b), 37, 58-59, 61, 64-65, 72, 80-82; Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Dytë, para 32, 40(a), 41, 44-47, 49, 51-55, 64-67, 69, 76.

³⁰ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 39, 43(a), citohet Gjykata Kushtetuese e Serbisë, lënda nr. UŽ-11470/2017, Aktgjykim, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë, nr. 127/2020; shih KSC-BC-2020-06, F00342, Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Kundërpërgjigjes Shtesë të Prokurorisë, publike, 4 qershor 2021, para 2-5.

të së drejtës për barazi para ligjit dhe ndalimit të diskriminimit sipas nenit 24 të Kushtetutës, nenit 14 të Konventës dhe nenit 26 të KNDCP-së.³¹

2. Ndalimi arbitrar dhe zhdukja me forcë

16. Parashtruesi i dytë argumentoi se akuzat kundër tij ishin jokushtetuese duke qenë se ato bazohen në veprime që ndalohen në kuadër të Ligjit, përfshirë nenet 13 dhe 14 të Ligjit, ose në kuadër të DZN-së, pa dispozita ndaluese korresponduese në Kodin Penal të RSFJ-së në fuqi më 1998.³² Konkretisht, lidhur me ndalimin arbitrar, parashtruesi i dytë argumentoi se nuk renditej shprehimisht si krim lufte në një konflikt të armatosur jondërkombëtar në nenin 14(1)(c) të Ligjit, i cili përmbante një listë shteruese të veprimeve të ndaluara.³³ Sido që të jetë, ndalimi arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar dhe zhdukja me forcë e personave nuk përbënin krime në DZN, në vitin 1998.³⁴ Rrjedhimisht, akuza të tilla kundër tij ishin shkelje të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës.³⁵

3. Ndërmarrja kriminale e përbashkët

17. Parashtruesi i dytë argumentoi se akuzat kundër tij ishin jokushtetuese duke qenë se bazoheshin në forma të përgjegjësive penale sipas Ligjit, përfshirë nenin 16 të tij, ose sipas DZN-së, pa format korresponduese në Kodin Penal të RSFJ-së më 1998.³⁶ Veçanërisht lidhur me NKP-në, parashtruesi i dytë gjithashtu argumentoi se Ligji nuk e përmendte këtë formë të përgjegjësive penale.³⁷ Gjithashtu parashtruesi i parë

³¹ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 43, 47-48, 51-54.

³² Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 3, 9, 14, 37; shih Mocioni Paraparak i Parashtruesit të Dytë, para 20-21, 37.

³³ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 89, 91; shih Mocioni Paraparak i Parashtruesit të Dytë, para 132, 135-137.

³⁴ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 101-115; Mocioni Paraparak i Parashtruesit të Dytë, para 38, 131, 144-147, 150, 158.

³⁵ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 7, 34; Mocioni Paraparak i Parashtruesit të Dytë, para 3, 5, 40(b), 57-59, 134, 136-137.

³⁶ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para 3, 9, 14, 37; Mocioni Paraparak i Parashtruesit të Dytë, para 33, 91.

³⁷ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para. 72; Mocioni Paraparak i Parashtruesit të Dytë, para 33, 91, 94-95.

argumentoi se NPK-ja nuk përfshihej brenda “kryerjes” në nenin 16(1)(a) të Ligjit, sepse ndryshe kjo do të përbënte një interpretim të zgjeruar të dispozitës penale në dëm të tij. Sido që të jetë, forma e zgjeruar e NKP-së nuk mund të përfshihej brenda kuptimit të “kryerjes”.³⁸

18. Gjithashtu, parashtruesi i parë argumentoi se përgjegjësia penale sipas NKP-së nuk kishte qenë e parashikueshme dhe e disponueshme për të më 1998, dhe se forma e zgjeruar e saj nuk kishte qenë pjesë e DZN-së në atë kohë.³⁹ Në mënyrë të ngjashme, parashtruesi i dytë argumentoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e kishte analizuar mjaftueshëm statusin e formës së zgjeruar të NKP-së në të drejtën zakonore ndërkombëtare.⁴⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu nuk kishte marrë parasysh zhvillimet e mëtejshme në lidhje me këtë formë të përgjegjësisë penale dhe nuk kishte përcaktuar një normë më të favorshme për të akuzuarin.⁴¹

C. RRËZIMI I KUNDËRSHTIMEVE TË PARASHTRUESVE

19. Më 23 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit rrëzoi kundërshtimet e parashtruesve ndaj juridiksionit të DHS-së.⁴²

1. E drejta zakonore ndërkombëtare

20. Lidhur me problemin nëse Kushtetuta ndalonte zbatimin e DZN-së, Paneli i Apelit theksoi se neni 19(2) i Kushtetutës përmendte “normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare”. Paneli i Apelit gjithashtu gjykoi se neni 19(1) i Kushtetutës i përmbahej parimit se DZN-ja ishte detyruese për të gjithë shtetet.

³⁸ Apeli i Parashtruesit të Parë, para 4(3), 69, 77; Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Parë, para 1, 14, 17-23, 70.

³⁹ Apeli i Parashtruesit të Parë, para 4(1),(2), 12, 54-61, 66-68; shih Mocionin Paraprak të Parashtruesit të Parë, para 1, 14, 24, 27-28, 39, 43, 49-50, 54, 70.

⁴⁰ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para. 85; Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Dytë, para 33, 105.

⁴¹ Apeli i Parashtruesit të Dytë, para. 87; Mocioni Paraprak i Parashtruesit të Dytë, para 34, 115.

⁴² KSC-BC-2020-06, IA009, F00030, Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 23 dhjetor 2021 (“Vendimi mbi Apelet”).

Për këtë arsye, nuk ishte e nevojshme ekzistenca e një dispozite korresponduese në të drejtën vendore në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara. Kjo ishte në pajtim me nenin 7 të Konventës. Nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ") rezultonte se një person mund të shpallej fajtor për një sjellje që ishte penalizuar në të drejtën ndërkombëtare në periudhën përkatëse dhe vetëm më vonë ishte përfshirë në legjislacionin e kodifikuar vendor.⁴³

21. Sa përket Kushtetutës së RSFJ-së, Paneli i Apelit theksoi se në pjesën e titulluar "Parimet Themelore" përfshihej zotimi për respektimin e rregullave përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, ku përfshihej DZN-ja dhe për përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare lidhur me organizatat ndërkombëtare ku bënte pjesë RSFJ-ja.⁴⁴ Gjithashtu, së paku disa prej krimeve të pretenduara ndodhën në një periudhë kur kishte qenë në fuqi Kushtetuta e Republikës Federale të Jugosllavisë e vitit 1992 ("Kushtetuta e RFJ-së"). Sipas Kushtetutës së RFJ-së, DZN-ja u bë pjesë përbërëse e sistemit juridik vendor.⁴⁵ Sido që të jetë, Kushtetuta zëvendësoi çfarëdo kushtetute të mëparshme në fuqi në territorin e Kosovës, përmes nenit 145(2) të saj.⁴⁶

22. Duke qenë se parashtruesi i dytë ngriti temën e [parimit] *lex mitior* sipas nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës (shih paragrafin 14 më lart), Paneli i Apelit rikujtoi se e drejta automatike për apel ishte vetëm për kundërshtimet ndaj

⁴³ Vendimi mbi Apelet, para 23-24, citohet ECtHR, *Penart v. Estonia* (dec.), nr. 14685/04, 24 January 2006, p. 10; *Šimšić v. Bosnia and Herzegovina* (dec.), no. 51552/10, 10 April 2012, para 23-25; *Kononov v. Latvia* [GC], no. 36376/04, ECHR 2010, para 237-244. Shih gjithashtu Vendimi mbi Apelet, para. 37. Në vendimin e tij Gjykatësi i Procedurës paraprake konkludoi se nuk ishte krijuar asnjë problem në kuadër të nenit 33 të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës ose nenit 15 të KNDCP-së. Faktikisht, sipas këtyre dispozitave, ligjvënësit mund të miratonin ligjin që përcaktonte krime që kishin ekzistuar në DZN në periudhën përkatëse, edhe pse ato nuk përmendeshin në legjislacionin vendor. Shih Vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 101.

⁴⁴ Vendimi mbi Apelet, para. 25.

⁴⁵ Vendimi mbi Apelet, para. 25.

⁴⁶ Vendimi mbi Apelet, para 26-27.

juridiksionit të DHS-së. Paneli i Apelit gjykoi se kjo nuk përbënte temë juridiksionale dhe për këtë arsye refuzoi ta trajtonte.⁴⁷

23. Duke qenë se parashtruesi i dytë iu referua jurisprudencës së gjykatave serbe (shih paragrafin 15 më lart), Paneli i Apelit konstatoi se bëhej fjalë për një kornizë juridike të ndryshme nga ajo që zbatohet në DHS.⁴⁸ Gjithashtu, detyrimi për të garantuar barazi para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit kishin të bënin me trajtimin e individëve brenda të njëjtit juridiksion. Të akuzuarit para DHS-së dhe të akuzuarit para gjykatave serbe gjykoheshin në juridiksione të ndryshme. Për këtë arsye, jurisprudenca e gjykatave serbe nuk ishte relevante.⁴⁹

2. Ndalimi arbitrar dhe zhdukja me forcë

24. Lidhur me nenin 14(1)(c) të Ligjit, Paneli i Apelit konfirmoi konstatimin e Gjykatësit të Procedurës paraprake se [ai nen] përmbante një listë joshteruese të veprimeve të ndaluara dhe për këtë arsye juridiksioni i DHS-së nuk kufizohej në veprimet e renditura shprehimisht atje.⁵⁰ Paneli i Apelit gjithashtu shprehu pajtimin se në DZN ekzistonte një rregull që e penalizonte ndalimin arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar si krim lufte,⁵¹ dhe zhdukjen me forcë si krim kundër njerëzimit.⁵² Sidoqoftë, konturet konkrete të ndalimit arbitrar do të trajtoheshin gjatë gjykimit.⁵³

⁴⁷ Vendimi mbi Apelet, para 52, 54, 57-59.

⁴⁸ Vendimi mbi Apelet, para 28, 44.

⁴⁹ Vendimi mbi Apelet, para. 45.

⁵⁰ Vendimi mbi Apelet, para. 87; shih Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para 144-146.

⁵¹ Vendimi mbi Apelet, para. 111; shih Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 166.

⁵² Vendimi mbi Apelet, para. 126; shih Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para 172, 174.

⁵³ Vendimi mbi Apelet, para. 100.

3. Ndërmarrja kriminale e përbashkët

25. Paneli i Apelit konstatoi se termi “kryerje” në nenin 16(1) të Ligjit duhet të interpretohet në pajtim me DZN-në e zbatueshme në periudhën përkatëse.⁵⁴ Paneli i Apelit arriti në përfundimin se neni 16(1) e paraqiste NKP-në si formë të përgjegjësive penale.⁵⁵ Për më tepër, forma bazë dhe e zgjeruar e NKP-së kishin ekzistuar në DZN në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara,⁵⁶ dhe në atë kohë kishin qenë të parashikueshme dhe të disponueshme për të akuzuarit.⁵⁷

26. Meqenëse NKP-ja ishte qartësisht e përkufizuar në ligj sikurse kërkohet në nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7(1) të Konventës, Paneli i Apelit rrëzoi argumentin e parashtruesit të parë në lidhje me interpretimin e zgjeruar të një dispozite penale në dëm të të akuzuarit.⁵⁸

III. SHKELJET E PRETENDUARA

27. Parashtruesi i parë i paraqiti ankesë Dhomës se forma bazë dhe e zgjeruar e NKP-së nuk përmendeshin në nenin 16(1)(a) të Ligjit dhe se gjatë periudhës së Aktakuzës, forma e zgjeruar e NKP-së nuk kishte qenë pjesë e DZN-së dhe nuk kishte qenë e disponueshme ose e parashikueshme për të.⁵⁹ Për këtë arsye, duke ngritur akuzën për NKP kundër tij, ZPS-ja kishte shkelur të drejtën e tij themelore sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7(1) të Konventës.⁶⁰

⁵⁴ Vendimi mbi Apelet, para. 138; shih Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 177.

⁵⁵ Vendimi mbi Apelet, para 135-143.

⁵⁶ Vendimi mbi Apelet, para 172, 186, 196; shih Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprak, para. 190. Sa i takon statusit zakonor të formës bazë të NKP-së, kjo pikë është përmendur në apel vetëm nga z. Thaçi, shih Vendimin mbi Apelet, para. 162.

⁵⁷ Vendimi mbi Apelet, para. 224.

⁵⁸ Vendimi mbi Apelet, para. 142.

⁵⁹ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Parë, para 2, 76.

⁶⁰ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Parë, para 1-2, 16, 76.

28. Parashtruesi i dytë paraqiti ankesë se bazuar në Ligjin e miratuar më 2015, ai ishte akuzuar për krime sipas DZN-së dhe një zbatim i tillë i drejtpërdrejtë i DZN-së shkelte të drejtat e tij sipas: (i) nenit 19 të Kushtetutës, për të cilin parashtruesi i dytë argumentoi se parimisht përjashtonte mundësinë e akuzave për krime sipas DZN-së;⁶¹ (ii) nenit 33(1)të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës dhe nenit 15 të KNDCP-së, që ndalojnë zbatimin me efekt prapaveprues të të drejtës penale;⁶² dhe (iii) në kombinim me nenin 7 të Konventës, – nenit 24 të Kushtetutës, nenit të Konventës, dhe nenit 26 të KNDCP-së.⁶³ Parashtruesi i dytë i kërkoi Dhomës që t'i deklaronte jokushtetuese, dispozitat e Ligjit që mundësojnë zbatimin e drejtpërdrejtë të DZN-së.⁶⁴

29. Parashtruesi i dytë gjithashtu u ankua se procedimi penal kundër tij bazuar në NKP dhe/ose ndalimin arbitrar kishte shkelur të drejtat e tij themelore të neneve 33 dhe 55 të Kushtetutës, duke qenë se Ligji nuk e përfshinte as NKP-në, as ndalimin arbitrar.⁶⁵

30. Gjithashtu, parashtruesi i dytë paraqiti ankesë se procedimi penal kundër tij i bazuar në formën e zgjeruar të NKP-së, ndalimin arbitrar dhe/ose zhdukjen me forcë ishte shkelje e parimit *nullum crimen sine lege* sipas nenit 33 të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës dhe nenit 15 të KNDCP-së, duke qenë se nuk përbënin krime sipas DZN-së më 1998.⁶⁶

IV. JURIDIKSIONI

31. Dhoma rikujton se parashtruesit i paraqitën kërkesat e tyre referuese në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës. Dhoma gjithashtu vëren se në kërkesat e tyre referuese

⁶¹ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para 7(a), 19, 22, 31(a), 91(a).

⁶² Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para 7(b), 33, 48(a), 91(b).

⁶³ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para 7(c), 64(a), 91(c).

⁶⁴ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para 24, 31(b), 48(b), 64(b), 91(d).

⁶⁵ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para 7(d), 66, 70-72, 91(e).

⁶⁶ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para 7(e), 88, 91(f).

përkatëse, parashtruesit ngritën disa ankesa në lidhje me procesin kundër tyre në DHS, konkretisht se procedimi penal kundër tyre i bazuar në disa akuza përbënte shkelje të të drejtave themelore të tyre të garantuara në Kushtetutë. Rrjedhimisht, kërkesat referuese kanë të bëjnë me DHS-në dhe ZPS-në, sikurse kërkohet në nenin 162(3) të Kushtetutës dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Si rrjedhojë, Dhoma ka juridiksion për të vendosur në lidhje me kërkesat referuese.

V. PRANUESHMËRIA

A. E DREJTA KUSHTETUESE NË DISKUTIM

32. Fillimisht, Dhoma vëren se parashtruesit ankohen se procedimi penal kundër tyre i bazuar në disa akuza shkeli të drejtat e tyre themelore të garantuara në Kushtetutë. Konkretisht, thelbi i ankesës së tyre ishte se veprat penale dhe kategoritë përkatëse të përgjegjesisë penale individuale: (i) bazoheshin në një burim ligjor të pazbatueshëm, DZN-në; (ii) nuk ishin të përcaktuara në Ligj; ose (iii) nuk përbënin krime në DZN gjatë periudhës së aktakuzës (shih paragrafët 27-30 më sipër).

33. Në lidhje me këtë, parashtruesit u mbështetën në nenin 33 të Kushtetutës, nenin 7 të Konventës dhe nenin 15 të KNDCP-së. Parashtruesi i dytë gjithashtu pretendon shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, nenit 14 të Konventës dhe nenit 26 të KNDCP-së në kombinim me nenin 7 të Konventës si dhe nenet 19 dhe 55 të Kushtetutës (shih paragrafët 27-30 më sipër).

34. Dhoma vëren se ankesat e parashtruesve ngrenë kryesisht një problem që ka të bëjë me nenin 33 të Kushtetutës. Duke qenë se parashtruesit mbështeten përkatësisht edhe në nenin 7 të Konventës dhe nenin 15 të KNDCP-së, Dhoma rikujton se në bazë të nenit 22(2) dhe (3) të Kushtetutës, këto garanci gjejnë zbatim në nivel kushtetues.⁶⁷

⁶⁷ Shih KSC-CC-2020-08, F00020/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të [REDAKTUAR] në vijim të Vendimit të Gjykatësit të Vetëm, 20 prill 2020 ("Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatësit të Vetëm"), para. 61; KSC-CC-2019-07, F00013, Vendim mbi Kërkesën Referuese të

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka ritheksuar se të drejtat dhe liritë e garantuara prej këtyre instrumenteve ndërkombëtare në nenin 22 të Kushtetutës “kanë statusin e normave të rendit kushtetues dhe janë pjesë integrale e Kushtetutës, në të njëjtën mënyrë si të gjitha dispozitat e tjera të Kushtetutës”.⁶⁸

35. Në bazë të sa më lart duke qenë autoriteti më i lartë në cilësimin ligjor të fakteve të çështjes që shqyrton,⁶⁹ Dhoma konstaton se kërkesat referuese shqyrtohen në kuadër të nenit 33 të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës dhe nenit 15 të KNDCP-së.

36. Sidoqoftë, para se Dhoma të shqyrtojë themelësinë e kërkesave referuese, ajo së pari duhet të përcaktojë nëse janë të pranueshme.⁷⁰ Për këtë arsye, Dhoma do të analizojë disa kritere të pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj, Rregullore, të cilat ekzistojnë në procedimin aktual.

B. A JANË TË PARAKOHSHME ANKESAT E PARASHTRUESVE

Driton Lajçit në lidhje me Procedurën e Marrjes në Pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, publik, 13 janar 2020 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit”), para. 14. Sa i takon përfshirjes së Konventës dhe Protokolleve të saj në legjislacionin e Kosovës në nivel kushtetues, shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Qemajl Kurtishi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*, KO 01/09, Aktgjykim, 27 janar 2010 (18 mars 2010), para. 40.

⁶⁸ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve [A.A.U.ZH. nr. 20/2019 të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH. no. 21/2019, të 5 nëntorit 2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*, KI 207/19, Aktgjykim, 10 dhjetor 2020 (5 janar 2021), para. 111.

⁶⁹ *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*, para. 15. Shih ECtHR, *Logachova and Others v. Ukraine*, nos 4510/05 and 3 others, 10 December 2009, para. 10; *Margaretić v. Croatia*, no. 16115/13, 5 June 2014, para. 75. Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*, Rev. 308/2007, me datë 10 qershor 2010, KI 120/10, Aktgjykim, 29 janar 2013 (8 mars 2013), para. 50.

⁷⁰ Shih *Vendim në lidhje me Vendimin e Gjykatësit të Vetëm*, para. 37. Shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ae nr. 287/18 të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 330/2019, të 1 gushtit 2019*, KI 195/19, Aktgjykim, 5 maj 2021 (31 maj 2021), para. 68; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 313/2018, të 10 dhjetorit 2018*, KI 12/19, Aktvendim për papranueshmëri, 10 prill 2019 (3 maj 2019), para. 30; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit PML. nr. 41/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 3 korrikut 2017*, KI 119/17, Aktvendim për Papranueshmëri i 3 prillit 2019 (3 maj 2019), para. 35.

37. Dhoma rikujton se në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(3) të Ligjit, individët janë të autorizuar t'i drejtohen Dhomës [lidhur me] “shkeljet [...] e të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë që pretendohen [...]”. Rregulla 14(f) e Rregullores përcakton se një referim është i papranueshëm në qoftë se asgjë në referim nuk krijon përshtypjen e një shkeljeje të një të drejte kushtetuese.

38. Sikurse theksohet më lart, parashtruesit pretendojnë se disa akuza kundër tyre përbëjnë shkelje të nenit 33 të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës dhe nenit 15 të KNDCP-së. Në të njëjtën kohë, procesi penal është në vazhdim dhe ende nuk është vendosur në lidhje me akuzat në fjalë. Për këtë arsye pyetja e parë që del është nëse ankesat e parashtruese në këtë fazë janë të parakohshme dhe më konkretisht nëse kanë të drejtë parashtruesit të pretendojnë se janë viktimat të shkeljeve të pretenduara.

1. A mund të pretendojnë parashtruesit se janë viktimat

(a) Parashtrimet

39. Parashtruesit argumentojnë se u bënë viktimat të shkeljeve të pretenduara me ngritjen e akuzave. Në këtë aspekt, ata theksuan se neni 33(1) i Kushtetutës përmend “akuzohet ose dënohet”, dhe rrjedhimisht zbatimi i tij nuk kushtëzohet prej shpalljes së fajësisë.⁷¹ Parashtruesit gjithashtu argumentojnë se neni 33(1) ofron më shumë mbrojtje se neni 7 i Konventës dhe neni 15 i KNDCP-së dhe se Dhoma kishte për detyrë ta zbatonte.⁷² Për më tepër, parashtruesi i dytë pretendon se në *Varvara v. Italy*, GJEDNJ-ja ka përdorur një interpretim të gjerë të nenit 7 të Konventës duke u shprehur se “[...] neni 7 [...] duhet të interpretohet dhe zbatohet [...] në një mënyrë të tillë që të sigurojë garanci të efektshme kundër ndjekjes penale, shpalljes së fajësisë

⁷¹ Parashtrimet e Parashtruesit të Parë, para. 14; Parashtrimet e Parashtruesit të Dytë, para 6, 8-9, 11, 13.

⁷² Parashtrimet e Parashtruesit të Parë, para 14-15; Parashtrimet e Parashtruesit të Dytë, para. 14.

dhe dënimit arbitrar [...]”.⁷³ Në mënyrë të ngjashme, parashtruesi i parë iu referua çështjeve ku GJEDNJ-ja kishte deklaruar, përfshirë në *Vasiliauskas v. Lithuania* [GC] dhe *Kononov v. Latvia* [GC],⁷⁴ dhe argumentuar se neni 7 zbatohet edhe në fazën e ndjekjes penale.⁷⁵ Gjithashtu, parashtruesi i parë argumentoi edhe se Gjykata Kushtetuese e Kosovës kishte përmendur parimin e lartpërmendur në lëndën nr. KI 11/21.⁷⁶

40. ZPS-ja argumenton se parashtruesit nuk janë shpallur fajtorë dhe për këtë arsye kërkesat e tyre referuese ishin të parakohshme.⁷⁷ Konkretisht ZPS-ja argumentoi se parimi *nullum crimen sine lege* në nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7(1) të Konventës mbrojnë një individ nga “shpallja fajtor” për një sjellje që nuk përbënte vepër penale në kohën e kryerjes. ZPS-ja thekson se neni 33(1) i Kushtetutës përdor një formulim të ndryshëm, konkretisht se një individ nuk mund “të akuzohet ose të dënohet”. Në lidhje me këtë pikë, ZPS-ja argumenton se neni 33(1) i Kushtetutës duhet të zbatohet në lidhje me nenin 7(1) të Konventës dhe sipas nenit 53 të Kushtetutës, në pajtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Sikurse GJEDNJ-ja ka konkluduar ndër të tjera në *Piskorski v. Poland* dhe Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut (“KomEDNJ”) në *Lukanov v. Bulgaria*, nëse një individ nuk është “shpallur fajtor” për një vepër penale, ai ose ajo nuk mund të konsiderohet viktimë e një shkeljeje të pretenduar të nenit 7 të Konventës.⁷⁸ Në lidhje me mbështetjen e parashtruesit të dytë

⁷³ Parashtrimet e Parashtruesit të Dytë, para 16-17, i referohet ndër të tjera ECtHR, *Varvara v. Italy*, no. 17475/09, 29 October 2013, para. 52.

⁷⁴ Parashtrimet e Parashtruesit të Parë, para. 17, i referohet ndër të tjera ECtHR, *Vasiliauskas v. Lithuania* [GC], no. 35343/05, ECHR 2015, para. 153, dhe *Kononov v. Latvia* [GC], cituar më lart, para. 185.

⁷⁵ Parashtrimet e Parashtruesit të Parë, para. 18.

⁷⁶ Parashtrimet e Parashtruesit të Parë, para. 18, i referohet Gjykatës Kushtetuese e Kosovës, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 325/2020 të 16 dhjetorit 2020*, KI 11/21, Aktvendim për papranueshmëri i 25 marsit 2021 (31 maj 2021), para. 78 (me referime të mëtejshme të jurisprudencës së GJEDNJ-së).

⁷⁷ Parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Parë, para 2, 28. Parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Dytë, para 2, 26.

⁷⁸ Parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Parë, para 2, 22-28, I referohet ndër të tjera ECtHR, *Piskorski v. Poland* (dec.), no. 80959/17, 22 October 2019, para. 61 and EComHR, *Lukanov v. Bulgaria*, no. 21915/93, Commission decision, 12 January 1995, Decisions and

edhe në nenin 15 të KNDCP-së, ZPS-ja argumenton se formulimi i nenit 15(1) të KNDCP-së ishte i njëjtë me atë të nenit 7(1) të Konventës.⁷⁹

(b) Analiza e Dhomës

41. Së pari, Dhoma rikujton se parashtruesit ankohen se janë “akuzuar” në shkelje të nenit 33 të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës, dhe nenit 15 të KNDCP-së. Për këtë arsye lind pyetja se a përmban Kushtetuta një garanci që të mos “akuzohesh” për një veprë penale për shkak të një sjelljeje që nuk përbënte veprë penale sipas ligjit në kohën e kryerjes.

42. Në këtë aspekt, Dhoma vëren se në pjesën përkatëse të nenit 33(1) të Kushtetutës në anglishte thuhet “askush nuk *akuzohet* ose dënohet [...]” (theksi i shtuar, përkthyer nga anglishtja).⁸⁰ Në versionin shqip të nenit 33(1) thuhet se “askush nuk mund të akuzohet ose dënohet [...]” (theksi i shtuar;).⁸¹ Në të njëjtin nen 33(1) në serbishte thuhet se “askush nuk *shpallet fajtor* ose dënohet [...]” (theksi i shtuar; përkthyer nga serbishtja).⁸²

43. Rrjedhimisht del se neni 33(1) i Kushtetutës është formuluar ndryshe në shqip dhe serbisht. Në kuadër të kërkesave referuese, ndryshimi i rëndësishëm është se në tekstin shqip përmendet termi “akuzohet” dhe në serbishte “shpallet fajtor”. Parashtruesit nuk janë “shpallur fajtorë” për veprat penale përkatëse. Rrjedhimisht, në këtë fazë të procesit penal, ata mund të kenë ose të mos kenë të drejtë të pretendojnë

Reports 80-A, f. 108. Parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Dytë, para 2, 20-26, duke iu referuar ndër të tjera po këtyre dy përfundimeve.

⁷⁹ Parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Dytë, para. 20.

⁸⁰ Teksti në anglishte i botuar në Gazetës Zyrtare të Kosovës më 9 prill 2008, at <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>> parë më 11 prill 2022.

⁸¹ Në shqip: “Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet [...].” Teksti në shqip i botuar në Gazetës Zyrtare të Kosovës më 9 prill 2008, at <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>> parë më 11 prill 2022.

⁸² Në serbisht: “Niko se ne može proglasiti krivim ili kazniti [...]” Teksti në serbisht i botuar në Gazetës Zyrtare të Kosovës më 9 prill 2008, at <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>> parë më 11 prill 2022.

se janë viktima të shkeljes së nenit 33(1) të Kushtetutës, varësisht nëse neni 33(1) përmend “akuzohet” apo “shpallet fajtor”.

44. Lidhur me ndryshimin midis teksteve në shqipe dhe serbishte, Dhoma thekson se në bazë të nenit 5(1) të Kushtetutës shqipja dhe serbishtja janë gjuhët zyrtare në Kosovë. Rrjedhimisht, të dy tekstet e nenit 33(1) të Kushtetutës janë ligjërisht të barasvlershme.⁸³ Si pasojë, Dhoma duhet të përdorë metoda të tjera të interpretimit kushtetues për të përcaktuar nëse neni 33(1) përmban garanci për të mos “akuzuar” ose “shpallur fajtor” për një sjellje që nuk përbënte vepër penale sipas ligjit në kohën e kryerjes. Në përdorimin e metodave të tjera të interpretimit, Dhoma duhet të jetë e kujdesshme që të mos krijojë normë kushtetuese të re, por të qartësojë përmbajtjen e një norme ekzistuese.⁸⁴

45. Dhoma thekson se Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka interpretuar dispozita kushtetuese lidhur me të drejtat dhe liritë themelore: (i) në pajtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së sipas nenit 53 të Kushtetutës (shih për shembull lëndët nr. KI 207/19, KI 195/19, KI 12/19, dhe KI 41/12);⁸⁵ dhe (ii) duke marrë parasysh ose në plotësim të dispozitës korresponduese të Kushtetutës (shih, për shembull lëndët nr. KI 12/19 dhe KO 01/09).⁸⁶ Në lidhje me këtë aspekt, Dhoma thekson se Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konfirmuar se çdo normë e Kushtetutës duhet të interpretohet në lidhje

⁸³ Shih gjithashtu nenin 5(4) të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, 1 mars 2007, ku shkruhet se të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare dhe se versionet në gjuhët zyrtare janë të barasvlershme. At <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440> parë më 11 prill 2022.

⁸⁴ Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së disa neneve të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*, KO 171/18, Aktgjykim i 25 prillit 2019 (20 maj 2019), para. 94.

⁸⁵ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 207/19, Aktgjykim, 10 dhjetor 2020 (5 janar 2021), para. 109; KI 195/19, cituar më lart, para. 94 në fund; KI 12/19, cituar më lart, para. 38; *Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës*, KI 41/12, Aktgjykim, 25 janar 2013 (26 shkurt 2013), para. 58.

⁸⁶ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 12/19, cituar më lart, para. 40; KO 01/09, cituar më lart, para. 40.

me normat e tjera të saj dhe jo më vete dhe asnjë normë kushtetuese nuk duhet të interpretohet mekanikisht (shih lënda nr. KO 72/20).⁸⁷

46. Sikurse u theksua më lart, neni 7 i Konventës dhe neni 15 i KNDCP-së kanë rangun e normave kushtetuese dhe janë pjesë përbërëse e Kushtetutës (shih paragrafi 34 më lart). Rrjedhimisht, neni 33 (1) i Kushtetutës duhet të lexohet së bashku me këto dispozita. Në lidhje me këtë pikë, Dhoma vëren se edhe neni 7(1) i Konventës, edhe neni 15(1) i KNDCP-së përcaktojnë se “askush nuk *shpallet fajtor* [...]” (theksi i shtuar). Këto dispozita, në ndryshim nga neni 33(1) i Kushtetutës në shqip, nuk përmendin “akuzohet”. Rrjedhimisht, interpretimi i nenit 33 të Kushtetutës duke mbajtur parasysh nenin 7 të Konventës dhe nenin 15 të KNDCP-së, sugjeron se neni 33(1) Kushtetutës i referohet “shpallet fajtor”. Ngjashëm, neni 11(2) i Deklaratës Universale për Të Drejtat e Njeriut (“DUDNJ”) përmend “shpallet fajtor”.⁸⁸

47. Në lidhje me këtë Dhoma vëren se faktikisht sikurse ka argumentuar parashtruesi i parë (shih paragrafin 39 në fund më lart), Gjykata Kushtetuese e Kosovës në lëndën nr. KI 11/21, zbatoi nenin 33 të Kushtetutës në kombinim me nenin 7 të Konventës. Duke iu referuar *Korbely v. Hungary* [GC], Gjykata Kushtetuese gjithashtu u shpreh se parimi i përcaktuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së se “[...] neni 7 [I Konventës] [...] duhet të interpretohet dhe zbatohet [...] në një mënyrë të tillë që të sigurojë garanci efektive mbrojtëse kundër ndjekjes penale, dënimit dhe ndëshkimit dhe dënimit arbitrar [...]”.⁸⁹ Sidoqoftë, Dhoma vëren se në *Korbely v. Hungary* [GC], GJEDNJ-ja shqyrtoi shkeljen e pretenduar të nenit 7 të Konventës ku

⁸⁷ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të 30 prillit 2020*, KO 72/20, Aktgjykim, 28 maj 2020 (1 qershor 2020), para. 346.

⁸⁸ Në lëndën nr. KI 15/19, Gjykata Kushtetuese e Kosovës i shqyrtoi nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës gjithashtu në kombinim me nenin 11 të DUDNJ-së, shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë NJN. Nr. 157/2017, i 13 prillit 2018*, KI 15/19, Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2020 (28 tetor 2020), para 70-71, 74, 79.

⁸⁹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 11/21, cituar më lart, para. 78, i referohet ECtHR, *Korbely v. Hungary* [GC], nr. 9174/02, ECHR 2008, para. 69.

parashtruesi në atë çështje ishte shpallur fajtor.⁹⁰ Më tej, Gjykata Kushtetuese Kosovës gjithashtu konstatoi se funksioni i saj në kontekstin e nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës ishte të shqyrtonte nëse vepra penale për të cilën parashtruesi ishte “shpallur fajtor”, ndër të tjera përbënte vepër penale të përkufizuar me disponueshmëri dhe parashikueshmëri të mjaftueshme.⁹¹ Gjithashtu, jurisprudencë tjetër e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës sugjeron se Gjykata ishte e përgatitur të diskutonte disa aspekte të nenit 33 në lidhje me elementin material, vetëm në rast se parashtruesi që i drejtohej Gjykatës Kushtetuese ishte shpallur fajtor në procese të mëhershme kundër tij ose saj (shih lëndët nr. KI 01/19 dhe KI 37/18;⁹² shih edhe lënda nr. KI 15/19 (lidhur me dënimin)).⁹³

48. Më tej, si rrjedhojë e shqyrtimeve të mëhershme, jurisprudenca e GJEDNJ-së luan rol të rëndësishëm në interpretimin e dispozitave të Kushtetutës për të drejtat dhe liritë themelore (shih paragrafin 45 më lart). Rrjedhimisht, Dhoma i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së në lidhje me nenin 7 të Konventës. Dhoma vëren se faktikisht në *Lukanov v. Bulgaria*, KomEDNJ arriti në përfundimin se, para përfundimit të procesit penal dhe pasi është shpallur fajtor, një individ nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së nenit 7.⁹⁴ Po ashtu, në çështjen *Tess v. Latvia*, GJEDNJ-ja konstatoi se objekti i nenit 7(1) të Konventës ishin persona të shpallur fajtorë dhe jo

⁹⁰ ECtHR, *Korbely v. Hungary* [GC], cituar më lart, para 54, 73-74, 76.

⁹¹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 11/21, cituar më lart, para. 83, shih gjithashtu para 72-93. Gjykata gjithashtu deklaroi se në bazë të nenit 33(1) të Kushtetutës, askush nuk mund të “shpallet fajtor” për një vepër penale e cila nuk ka qenë e ndëshkueshme me ligj në kohën përkatëse, shih po aty., para. 75.

⁹² Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, PML. Nr. 242/2017, i 30 prillit 2018, KI 01/19, Aktvendim për papranueshmëri i 2 shtatorit 2020 (1 tetor 2020), para 82-86, 154-166; *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme*, Pml. nr. 225/2017, i 18 dhjetorit 2017, KI 37/18, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 majit 2018 (11 qershor 2018), para 55-58. Shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme*, PML. nr. 247/2017, të 6 shkurtit 2018, KI 95/18, Aktvendim për papranueshmëri i 27 majit 2019 (19 gusht 2019), para 11-15, 37-40.

⁹³ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 15/19, cituar më lart, para 70-79.

⁹⁴ EComHR, *Lukanov v. Bulgaria*, cituar më lart, f. 108; shih gjithashtu EComHR, *Klamecki v. Poland*, no. 31583/96, Commission decision, 20 October 1997, para. 4 (Law part of the decision/pjesa juridike e vendimit); *Tomasi v. France*, no. 13853/88, Commission decision, 10 March 1989.

të akuzuar kundër të cilëve zhvillohej proces penal.⁹⁵ Në lidhje me këtë, Dhoma thekson se parashtruesit argumentojnë se GJEDNJ-ja ka konfirmuar se një individ mund të mbështetet në nenin 7 të Konventës edhe për fazën e ndjekjes penale, para shpalljes së verdiktit të fajësisë (shih paragrafi 39 më lart). Dhoma vëren se në të gjitha çështjet ku mbështeten parashtruesit për argumentin e tyre, GJEDNJ-ja kishte shqyrtuar pretendimin për shkelje të nenit 7 të Konventës në rrethanat ku parashtruesi ishte shpallur fajtor.⁹⁶ Rrjedhimisht, Dhoma nuk është bindur se në ato çështje, GJEDNJ-ja devijoi nga qëndrimi i saj i lartpërmendur në lidhje me nenin 7 të Konventës e cila është që një individ mund të mbështetet në këtë nen pasi të jetë shpallur fajtor.

49. Rrjedhimisht, neni 33(1) i Kushtetutës, i interpretuar në pajtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së, duhet interpretuar se i referohet nuk “shpallet fajtor”. Në lidhje me zbatimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së, Dhoma gjithashtu vëren se Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka nxjerrë përfundimin se në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, është e obliguar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, në pajtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së,⁹⁷ dhe, më tej, se është *obligim kushtetues*.⁹⁸ Për më tepër edhe po të kishte mospërputhje midis të dyve, parësi kanë standardet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së.⁹⁹

⁹⁵ ECtHR, *Tess v. Latvia* (dec.), no. 34854/02, 12 December 2002; shih gjithashtu *Piskorski v. Poland* (dec.), cituar më lart, para. 61; *Hanuliak and Others* (dec.), no. 63859/00, 18 September 2007, para. 3 (Law part of the decision).

⁹⁶ Shih ECtHR, *Vasiliauskas v. Lithuania* [GC], cituar më lart, para 114, 121, 162; *Del Río Prada v. Spain* [GC], no. 42750/09, ECHR 2013, paras 56, 80; *S.Ë. v. the United Kingdom*, 22 November 1995, Series A no. 335-B, paras 28, 32, 47; *Seychell v. Malta*, no. 43328/14, 28 August 2018, para. 41; *Camilleri v. Malta*, no. 42931/10, 22 January 2013, paras 22, 40; *Kononov v. Latvia* [GC], cituar më lart, paras 143, 187.

⁹⁷ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 195/19, cituar më lart, para. 94 në fund; KI 12/19, cituar më lart, para. 38; KI 119/17, cituar më lart, para. 44.

⁹⁸ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 41/12, cituar më lart, para. 58; *Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 91/2013, të 21 qershorit 2013*, KI 116/13, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 tetorit 2013 (16 dhjetor 2013), para. 26.

⁹⁹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 207/19, cituar më lart, para. 109.

50. Në të njëjtën kohë, Dhoma vëren se faktikisht, sikurse kanë vënë në dukje parashtruesit, lind pyetja nëse qëndrimi i lartpërmendur vlen njësoj edhe kur në rrethana si në çështjen aktuale, një dispozitë kushtetuese në një nga gjuhët zyrtare duket në pamje të parë më e gjerë se dispozita gjegjëse e Konventës, sipas interpretimit të GJEDNJ-së.

51. Në këtë aspekt, Dhoma thekson se në lëndën nr. KI 12/19, Gjykata Kushtetuese e Kosovës interpretoi një dispozitë të ndryshme të Kushtetutës, nenin 31. Konkretisht nga arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese del se Gjykata arriti në përfundimin se paragrafi 2 i nenit 31 i referohej të drejtës për gjykim të drejtë “për cilëndo akuzë penale”.¹⁰⁰ Vlen të theksohet se për interpretimin e frazës “për cilëndo akuzë penale”, Gjykata Kushtetuese iu referua dispozitës përkatëse të Konventës, konkretisht, nenit 6(1) dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, dhe në atë kontekst, konstatoi se interpretimi i kuptimit të frazës duhej të ishte “për cilëndo akuzë penale të ngritur kundër parashtruesit [para Gjykatës Kushtetuese]” (theksi i shtuar).¹⁰¹

52. Pa trajtuar nëse faktikisht formulimi i nenit 31(2) të Kushtetutës mund të konsiderohet më i gjerë se formulimi i nenit 6(1) të Konventës,¹⁰² Dhoma i referohet parimisht qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Konkretisht, del se në rastet kur Gjykata mori në shqyrtim një frazë më të përgjithshme në një dispozitë kushtetuese, ajo e përcaktoi fushëveprimin e saj duke mbajtur parasysh dispozitën korresponduese të Konventës dhe duke mbajtur parasysh si duhet jurisprudencën e GJEDNJ-së, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës.

¹⁰⁰ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 12/19, cituar më lart, para 36, 40, 44.

¹⁰¹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 12/19, cituar më lart, para 36-40, 44-45, 49, i referohet ndër të tjera ECtHR, *Rékási v. Hungary* (dec.), no. 31506/96, 25 nëntor 1996. Për të njëjtin qëndrim nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, shih *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Pa/1. nr. 1160/2017, të 18 dhjetorit 2017*, KI 52/18, Aktvendim për papranueshmëri i 16 janarit 2019 (21 shkurt 2019), para 40-42, 47-49, 53.

¹⁰² Dhoma vëren se ndërsa në versionin anglisht të nenit 31(2) të Kushtetutës përmendet “any criminal charges/cilëndo akuzë penale”, në versionet në shqip dhe serbisht të nenit 31(2) të Kushtetutës përmendet “cilëndo akuzë penale [..] kundër tij/saj”.

53. Duke marrë parasysh sa më lart dhe se neni 33(1) i Kushtetutës në gjuhën tjetër zyrtare përmend garancinë për të mos u “shpallur fajtor”, Dhoma nuk është bindur se mund të interpretohet se neni 33(1) I Kushtetutës përmban garancinë për të mos u “akuzuar”.¹⁰³ Sikurse u theksua më lart, as neni i 7 i Konventës, as neni 15 i KNDCP-së nuk përmbajnë një garanci të tillë. Rrjedhimisht ankesat e parashtruesve janë të parakohshme. Në këtë fazë të procesit penal, të akuzuarit nuk mund të pretendojnë se janë viktimat të shkeljeve të nenit 33 të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës ose nenit 15 të KNDCP-së.

54. Sidoqoftë, Dhoma thekson se përfundimi i saj i mësipërm lidhur me nenin 33 të Kushtetutës nuk nënkupton parimisht se një dispozitë kushtetuese nuk mund të ofrojë më shumë mbrojtje se Konventa. Dhoma arriti në këtë përfundim në rrethana specifike ku neni 33(1) i Kushtetutës në një nga gjuhët zyrtare i referohet garancisë për të mos u “shpallur fajtor” dhe në një gjuhë zyrtare tjetër për të mos u “akuzuar” dhe Dhoma nuk gjeti argumente mbështetëse për opsionin e dytë në nenin 33, pasi shqyrtoi praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, edhe në lidhje me zbatimin e nenit 53 të Kushtetutës.

2. Përfundim

55. Rrjedhimisht, Dhoma nxjerr përfundimin se duke mbajtur parasysh konstatimet e saj në lidhje me aspektin nëse parashtruesit mund të konsiderohen viktimat, kërkesat referuese në këtë fazë të procesit janë të parakohshme dhe, për këtë arsye, prej tyre gjithashtu nuk duket se janë shkelur të drejtat e parashtruesve sipas nenit 33(1) të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës dhe nenit 15 të KNDCP-së. Për pasojë, kërkesat

¹⁰³ Theksohet gjithashtu se në një komentari të nenit 33(1) të Kushtetutës së Kosovës nuk sugjerohet se përmban garancinë që nuk do të “akuzohet”, shih Hasani, E., Čukalović, I., Komentari: Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Botimi 1), GIZ 2013, f. 112-123.

referuese duhet të shpallen të papranueshme në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 14(f) të Rregullores së Punës.

56. Megjithëse Dhoma gjykon se kërkesat referuese duhet të rrëzohen për arsyet e lartpërmendura, ajo rikujton se në bazë të nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së Punës, një individ mund t'i paraqesë kërkesë referuese Dhomës pasi të ketë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara në ligj kundër shkeljeve të pretenduara. Në lidhje me këtë, Dhoma thekson se sipas nenit 47 të Ligjit, një panel i Gjykatës Supreme të DHS-së, në raste të përcaktuara konkretisht shqyrton apele kundër vendimit të panelit të Gjykatës së Apelit dhe se neni 48(6),(7) i Ligjit përcakton se pas daljes së një aktgjykimi të formës së prerë, një paneli të Gjykatës Supreme mund t'i paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ndër të tjera në lidhje me shkelje të së drejtës penale.¹⁰⁴ Rrjedhimisht del se ky është një nga mjetet juridike që do të duhej të shfrytëzohej në kontekstin e shterimit të mjeteve juridike lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës.¹⁰⁵ Gjithsesi, duke mbajtur parasysh se kërkesat referuese janë të parakohshme, Dhoma gjykon se në këtë moment nuk është e nevojshme që të nxjerrë përfundim lidhur me kriterin e shterimit të mjeteve juridike.

¹⁰⁴ Dhoma vë në dukje se parashtrimet e parashtruesve në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, shih Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Parë, para 9, 11-13, 17; Parashtrimet e Parashtruesit të Parë, para 2, 25-27, 30, 33-34, 36; Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para 8, 13, 17, 65, 74; Parashtrimet e Parashtruesit të Dytë, para 4, 18-19, 21-27. Shih gjithashtu Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Parë, para 2, 12-19, i referohet ndër të tjera *Vendimit mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*, para. 24, dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, *Malush Sopa, Sedat Kuqi, Fazli Morina, Rahman Kabashi dhe Liman Gashi*, KI 08/11, Aktvendim për Papranueshmëri i 23 nëntorit 2011 (24 prill 2012), para 46-48; Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Dytë, para 2, 8-17, ndër të tjera përmendin po këto dy përfundime.

¹⁰⁵ Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 01/19, cituar më lart, para 31-41, 82-85, 91-93; KI 95/18, cituar më lart, para 3, 12-17, 22; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*, Pml. nr. 63/2018, i 4 qershorit 2018, KI 155/18, Aktvendim për papranueshmëri, 25 shtator 2019 (21 tetor 2019), para 4, 20-25, 29, 36-39, 45-52; Shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*, Pml. nr. 141/2018, të 2 korrikut 2018 dhe *Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë*, P. nr. 571/13, të 2 shkurtit 2018, KI 158/18, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit (23 prill 2019), para 40-41.

57. Lidhur me argumentet e parashtruesve për kohëzgjatjen e procesit penal, Dhoma thekson se parashtruesit nuk kanë ngritur ankesa në atë aspekt sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës. Po ashtu, parashtruesi i dytë nuk ka ngritur ankesë në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit të tij sipas nenit 29(2) të Kushtetutës dhe nenit 5(3) të Konventës.¹⁰⁶ Megjithëse për vlerësimin e statusit të viktimës dhe shterimit të mjeteve juridike lidhur me ankesa të tilla do të nevojiten elemente të tjera, ato nuk ndikojnë në vlerësimin e ankesave të ngritura në çështjen aktuale.

58. Në të njëjtën kohë, Dhoma vëren se në kërkesën referuese të parashtruesit të dytë ngrihet një aspekt themelor në lidhje me kornizën ligjore të DHS-së. Konkretisht, parashtruesi i dytë ka argumentuar se parimisht, me zbatimin e drejtpërdrejtë të DZN-së në lidhje me disa vepra penale, përfshirë edhe forma të përgjegjesisë penale individuale, DHS-ja veprimi kundër Kushtetutës. Duke marrë parasysh karakterin themelor të këtij problem në funksionimin e DHS-së, Dhoma e gjykon të përshtatshme ta trajtojë. Sidoqoftë, meqenëse procesi penal kundër të akuzuarve nuk ka përfunduar dhe rrjedhimisht kërkesat referuese janë të parakohshme, Dhoma duhet të jetë e kujdesshme në këtë fazë që të mos ndërhyjë në kompetencat e paneleve të tjerë të DHS-së në nxjerrjen e përfundimeve për pika juridike dhe faktike që lidhen me çështjen penale në shqyrtim prej tyre.

C. A DUKET SE ËSHTË KRYER SHKELJE PËR SHKAK TË ZBATIMIT TË DREJTPËRDREJTË TË DZN-SË NGA DHS-JA

1. Fushëveprimi i vlerësimit

59. Siç theksohet më lart, dhe duke pasur parasysh që procedimi penal kundër parashtruesit të dytë është në kryerje e sipër, Dhoma duhet të rikujtojë së pari se është detyrë e paneleve të tjera të DHS-së që të shqyrtojnë faktet dhe provat në përputhje

¹⁰⁶ Shih, *mutatis mutandis*, ECtHR, *Bouglame v. Belgium* (dec.), no. 16147/07, 2 March 2010.

me kompetencat përkatëse të tyre, si edhe të interpretojnë dhe të zbatojnë dispozitat ligjore që lidhen me çështjen nën shqyrtim prej tyre.¹⁰⁷ Sikurse rrjedh nga praktika e mëparshme e Dhomës, pasi panelet kompetente të DHS-së kanë pasur mundësi të shqyrtojnë këto aspekte, Dhoma mund të vlerësojë konstatimet e tyre për sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë.¹⁰⁸ Gjithashtu, dhe siç u përmend, Dhoma vëren se pyetja lidhur me zbatimin e drejtpërdrejtë të DZN-së nga DHS-ja për sa i përket krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit dhe formave të përgjegjesisë penale të lidhura me to, është me rëndësi kushtetuese kyçe dhe themelore në kornizën ligjore të DHS-së.

60. Bazuar në sa më sipër, Dhoma mendon se, në këtë fazë të procesit, është e mundur të japë mendim vetëm mbi pyetjen më të përgjithshme se a duket se zbatimi i drejtpërdrejtë i DZN-së nga DHS-ja për sa i përket krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, përfshirë format e përgjegjesisë penale të lidhura me to, shkakton shkelje të Kushtetutës, sipas rregullës 14(f) të Rregullores.

61. Në të njëjtën kohë, Dhoma duhet të theksojë se vlerësimi i saj nuk paragjykon asnjë vendim të ardhshëm mbi ankesat, nëse do të ketë të tilla, që parashtuesit mund t'i parashtrojnë Dhomës përkitazi shkeljes së pretenduar të nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës lidhur posaçërisht me vendimin mbi përgjegjësinë penale të tyre, në rast se në fakt do të ketë një vendim të tillë.

¹⁰⁷ Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së 16 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra ndërmjet 26 marsit dhe 12 prillit 2018*, KI 96/18 dhe të tjerë, Aktvendim për papranueshmëri, 30 janar 2019 (19 shkurt 2019), para. 51; KI 37/18, cituar më lart, para. 39; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PA-II-KZ-II-7/15 të 26 nëntorit 2015*, KI 15/16, Aktvendim për papranueshmëri, 16 mars 2016 (5 prill 2016), para. 40; *Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML-KZZ nr. 170/2014 të 19 shkurtit 2015*, KI 38/15, Aktvendim për papranueshmëri, 11 shtator 2015 (2 nëntor 2015), para. 30.

¹⁰⁸ *Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm*, para. 36. Shih ECHR, *Sisojeva and Others v. Latvia* (striking out) [GC], no. 60654/00, ECHR 2007-I, para. 89. Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 37/18, cituar më lart, para. 41-43; *Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë Pkl.nr 45/12 të datës 18 qershor 2012*, KI 85/12 dhe KI 86/12, Aktvendim për papranueshmëri, 21 janar 2013 (22 janar 2013), para. 28.

2. Parashtrimet

62. Sipas parashtruesit të dytë, zbatimi i drejtpërdrejtë i DZN-së lidhur me krimet sipas DZN-së është në shkelje të nenit 19 të Kushtetutës, sepse ky nen parasheh efektin e drejtpërdrejtë të dispozitave konkrete vetëm të marrëveshjeve ndërkombëtare. Edhe nëse “normat juridikisht të detyrueshme” në nenin 19(2) e përfshijnë DZN-në, neni 19(1) e ndalon efektin e drejtpërdrejtë të saj.¹⁰⁹ Parashtruesi i dytë gjithashtu argumentoi se zbatimi i drejtpërdrejtë i DZN-së është në shkelje të nenit 33(1) të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës dhe nenit 15 të KNDCP-së të cilët ndalojnë zbatimin prapaveprues të së drejtës penale. Për t’iu përmbajtur këtyre dispozitave, DHS-ja duhej të zbatonte ligjet në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara, konkretisht, Kodin Penal të RSFJ-së dhe Kushtetutën e RSFJ-së, që ndalonte zbatimin e DZN-së. Gjithashtu, parashtruesi i dytë argumentoi se DZN-ja nuk është e zbatueshme, sepse fjala “ligj” në nenin 33(1) të Kushtetutës, mbi bazën e të cilit mund të ndiqej penalisht një individ, u referohej ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, si në nenin 55 të Kushtetutës.¹¹⁰

63. ZPS-ja parashtroi se neni 19(1) i Kushtetutës nuk përmban asnjë ndalim të përgjithshëm të efektit të drejtpërdrejtë të së drejtës ndërkombëtare. Gjithashtu, çfarëdo interpretimi i tillë do të ishte mospërputhës me nenin 19(2), sipas të cilit “normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare”, që përfshijnë DZN-në, kanë epërsi mbi ligjet e Kosovës. ZPS-ja argumentoi gjithashtu se neni 33(1) i Kushtetutës parasheh ndjekjen penale të krimeve “sipas së drejtës ndërkombëtare”, dhe, sikurse ka konstatuar edhe GJEDNJ-ja në lidhje me nenin 7 të Konventës, kjo lejon ndjekjen penale të sjelljeve të cilat penalizoheshin sipas DZN-së në periudhën në fjalë. Për këtë arsye, Ligji mund të përfshijë krimet e parapara në DZN.¹¹¹

¹⁰⁹ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para. 7(a), 15, 19, 22, 28, 31.

¹¹⁰ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para. 7(b), 39-40, 44, 46, 48. Shih, Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para. 30-34, 38, 41.

¹¹¹ Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me Kërkesën Referuese të Parashtruesit të Dytë, para. 29-31, 37.

3. Shqyrtimi i Dhomës

(a) A parashikon neni 19 i Kushtetutës zbatimin e DZN-së

64. Fillimisht, Dhoma vëren se paneli i Gjykatës së Apelit konstatoi se “neni 19(1) i Kushtetutës” i përmbahet parimit se shtetet kanë detyrimin ta zbatojnë DZN-në sepse ajo është një ndërthurje e një praktike juridike tashmë të rrënjosur, të përhapur dhe përputhëse nga ana e tyre, me *opinio juris*, domethënë, bindjes se praktika në fjalë është detyruese.¹¹² Gjithashtu, paneli i apelit konstatoi se nuk ka asnjë kundërshti ndërmjet “të drejtës zakonore ndërkombëtare” në nenet 3(2)(d) dhe 12 të Ligjit, nga njëra anë, dhe “normave të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare” në nenin 19(2) të Kushtetutës, nga ana tjetër.¹¹³

65. Dhoma vëren se arsyetimi i panelit të Gjykatës së Apelit mund të sugjerojë se neni 19(1) i Kushtetutës i referohet DZN-së. Megjithatë, neni 19(1) nuk i referohet DZN-së, por “marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara”. Paneli i Apelit mund të ketë dashur të thotë se neni 19, në tërësi, ose ndoshta paragrafi (2) i tij në veçanti i përmbahet parimit të efektit detyrues të DZN-së mbi shtetet. Gjithsesi, Dhoma vëren se pyetja lidhur me efektin detyrues të DZN-së mbi shtetet si aspekt i së drejtës ndërkombëtare publike është e ndryshme nga pyetja lidhur me zbatimin e drejtpërdrejtë të DZN-së në sistemin e brendshëm juridik të një shteti.

66. Pyetja aktuale për shqyrtim është se a parasheh neni 19 i Kushtetutës zbatimin e drejtpërdrejtë të DZN-së në sistemin juridik të Kosovës. Në bazë të nenit 3(4) të Ligjit, dispozitat e legjislacionit të Kosovës që janë përfshirë shprehimisht në Ligj përbëjnë kornizën ligjore autonome të DHS-së.¹¹⁴ Një nga këto dispozita është neni 19 i Kushtetutës, sepse neni 3(2)(a),(d) i Ligjit përcakton se DHS-ja gjykon dhe funksionon

¹¹² Vendimi i Apelit, para. 23.

¹¹³ Vendimi i Apelit, para. 24.

¹¹⁴ Dhoma ka përcaktuar më herët se DHS dhe ZPS-ja udhëhiqen nga korniza ligjore e tyre autonome, shih KSC-CC-2020-11, F00015, Aktgjykim mbi Referimin e Amendamenteve të Propozuara të Kushtetutës së Kosovës, publik, 26 nëntor 2020, para. 56-58, 62-63.

në përputhje me Kushtetutën dhe në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare “së cilës i është dhënë përparësi kundrejt ligjeve vendase me nenin 19(2) të Kushtetutës”. Rrjedhimisht, për të përcaktuar nëse, si parim i përgjithshëm, në DHS mund të zbatohen drejtpërsëdrejti veprat penale sipas DZN-së, Dhoma duhet të përcaktojë nëse Kushtetuta e parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të DZN-së.

67. Në përgjigje të pyetjes specifike nëse neni 19 i Kushtetutës parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të DZN-së, Dhoma rikujton konstatimin e saj të mëhershëm se ajo duhet t'i interpretojë dispozitat kushtetuese jo më vete, por në lidhje me dispozitat e tjera kushtetuese (shih paragrafin 45 më lart). Megjithatë përpara se ta bëjë këtë, Dhoma e gjykon të përshtatshme që së pari të rikujtojë se neni 19 i Kushtetutës thotë:

Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

68. Dhoma vëren se neni 19 titullohet “Zbatimi i së drejtës ndërkombëtare”. Sikurse e sugjeron edhe titulli, neni 19 nuk kufizohet në aspektin e zbatueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, por ka të bëjë edhe me burime të tjera të së drejtës ndërkombëtare. Në përputhje me këtë, paragrafi (2) u referohet normave juridikisht të detyrueshme të të drejtës ndërkombëtare.¹¹⁵ Duke qenë se kjo referencë është krahas asaj të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, rrjedh që normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare janë norma që vijnë nga një

¹¹⁵ Dhoma vëren se neni 19(2) i Kushtetutës në gjuhën serbe përmend “parime juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare”. Në serbishte: “[...] *obavezna načela međunarodnog prava* [...]”. Teksti në serbishte i botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës më 9 prill 2008, at <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, parë më 11 prill 2022.

burim i së drejtës ndërkombëtare i ndryshëm nga traktatet ndërkombëtare. Për qëllimet e këtij shqyrtimi, një burim i tillë është, pa dyshim DZN-ja.¹¹⁶ Rrjedh që normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare që përmenden në nenin 19(2) e përfshijnë DZN-në.

69. Sa i takon mënyrës në të cilën zbatohet DZN-ja në sistemin juridik të Kosovës, Dhoma vëren se neni 19 i Kushtetutës nuk parasheh shprehimisht zbatimin e drejtpërdrejtë të normave juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, në ndryshim nga disa norma të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara. Megjithatë, në të njëjtën kohë, në paragrafin (2) të nenit 19 thuhet se normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, ashtu si marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, “kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës”. Në lidhje me këtë, Dhoma thekson se legjislacioni i Kosovës zbatohet drejtpërdrejt. Rrjedhimisht, për të siguruar që normat përkatëse juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare të kenë epërsi në këtë zbatim të legjislacionit të brendshëm, sikurse parashihet në nenin 19(2), duhet të ekzistojë mundësia që këto norma të zbatohen drejtpërsëdrejti.

70. Në të njëjtën kohë, nuk është e nevojshme që në kuadër të këtij diskutimi Dhoma të nxjerrë përfundim nëse, sipas nenit 19 të Kushtetutës, në sistemin e brendshëm juridik të Kosovës zbatohet drejtpërdrejt çfarëdo norme e DZN-së.¹¹⁷ Pyetja e shtruar për Dhomën është më e kufizuar, sepse ka të bëjë me normat e DZN-së që kanë lidhje me veprat penale në fjalë, sidomos për sa u përket krimeve të luftës dhe krimeve

¹¹⁶ Shih nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, ku jepen burimet e pranuar zyrtarisht të së drejtës ndërkombëtare.

¹¹⁷ Dhoma vëren praktikën e gjykatave të Kosovës në një fushë tjetër, që nuk është ajo që po shqyrtohet nga Dhoma në këtë rast. Konkretisht, gjykatat e Kosovës në një çështje që kishte të bënte me kërkesën për ekstradimin e një personi shqyrtuan nëse Kosova bartte detyrimet e një traktati që u paraqit si bazë për ekstradimin. Në këtë kontekst specifik, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se disa norma në fushën e bartjes së detyrimeve të shteteve ndaj traktateve ndërkombëtare pasqyronin DZN-në dhe, si rrjedhojë, u referoheshin atyre. Në atë çështje, Gjykata Supreme e Kosovës u shpreh gjithashtu se “epërsia e së drejtës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në Kosovë parashihet nga neni 19, paragrafi 2 i Kushtetutës [...]”. Shih, Gjykata Supreme e Kosovës, Pn-Kr-386/2010, Aktgjykim, 7 shtator 2010, f. 4, 6.

kundër njerëzimit, përfshirë edhe format përkatëse të përgjegjësisë penale. Për të përcaktuar nëse DHS mund t'i zbatojë drejtpërdrejt këto norma të DZN-së për të vërtetuar përgjegjësi penale, Dhoma duhet të analizojë se cilat standarde përcaktojnë zbatimin e tyre të drejtpërdrejtë në fushën e caktuar.

71. Në këtë drejtim, Dhoma vëren se në lëndën nr. KO 45/18 dhe KO 95/13, Gjykata Kushtetuese e Kosovës pranoi se, sipas nenit 19 të Kushtetutës, dispozitat e vetëzbatueshme të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara janë të një rendi më të lartë se legjislacioni i Kosovës, por në një rend juridik më të ulët se Kushtetuta. Sa i takon zbatimin të drejtpërdrejtë të këtyre dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, Gjykata konstatoi se zbatimi i tyre *i nënshtrohet Kushtetutës*.¹¹⁸ Duke qenë se neni 19(2) përmend epërsinë, si të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara ashtu edhe të normave juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, të njëjtat konstatime të Gjykatës Kushtetuese duhet të vlejné edhe për zbatimin e DZN-së, pra që zbatimi i DZN-së i nënshtrohet Kushtetutës.

72. Për të identifikuar standardet kushtetuese që lidhen me çështjen aktuale, Dhoma rikujton se pyetja që shtrohet para saj është nëse, si parim i përgjithshëm, DHS-ja mund të zbatojë normat e DZN-së lidhur me krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, përfshirë format përkatëse të përgjegjësisë penale, për vërtetimin e fajësisë së parashtruesit të dytë, sipas rastit. Rrjedh që zbatimi i këtyre normave të DZN-së i nënshtrohet nenit 33 të Kushtetutës, që parasheh garancitë lidhur me bazat ligjore mbi të cilat një gjykatë mund të konstatojë se një individ është fajtor për një vepër penale. Për këtë arsye, Dhoma do t'u kthehet tani këtyre standardeve.

¹¹⁸ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi*, KO 45/18, Aktgjykim, 18 prill 2018 (30 prill 2018), para. 65; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 04/L-199, për Ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje*, KO 95/13, Aktgjykim, 2 shtator 2013 (9 shtator 2013), para. 52.

(b) A është zbatimi i drejtpërdrejtë i DZN-së në përputhje me nenin 33 të Kushtetutës

73. Dhoma fillimisht rikujton konstatimin e saj të mëhershëm se fjala “akuzohet” në nenin 33(1) të Kushtetutës në gjuhën shqipe duhet të lexohet si “shpallet fajtor” (shih paragrafin 53 më lart). Duke pasur këtë parasysh, Dhoma vëren se neni 33 i Kushtetutës në anglishte thotë:

Article 33 [The Principle of Legality and Proportionality in Criminal Cases]

1. No one shall be charged or punished for any act which did not constitute a penal offense under law at the time it was committed, except acts that at the time they were committed constituted genocide, war crimes or crimes against humanity according to international law.
2. No punishment for a criminal act shall exceed the penalty provided by law at the time the criminal act was committed.
3. The degree of punishment cannot be disproportional to the criminal offense.
4. Punishments shall be administered in accordance with the law in force at the time a criminal act was committed, unless the penalties in a subsequent applicable law are more favourable to the perpetrator.

74. Dhoma vëren se neni 33(1) i Kushtetutës parasheh shprehimisht mundësinë që një person mund të shpallet fajtor për një vepër që, në kohën e kryerjes përbënte krim lufte ose krim kundër njerëzimit “sipas së drejtës ndërkombëtare”. E njëjta gjë rrjedh edhe nga neni 7 i Konventës dhe neni 15 KNDCP-së, që i referohen një veprimi ose mosveprimi që përbënte vepër penale “sipas të drejtës ndërkombëtare” në kohën kur u krye. Në lidhje me këtë, Dhoma vëren se neni 33(2), (3) dhe (4) i Kushtetutës parasheh garanci për sa i përket ndëshkimeve. Rrjedhimisht, dispozita përkatëse për pyetjen konkrete të shtruar para Dhomës lidhur me veprat penale sipas DZN-së është neni 33(1) i Kushtetutës.

75. Për të përcaktuar nëse DHS-ja mund t'i zbatojë normat e DZN-së si pjesë e “së drejtës ndërkombëtare” paraparë në nenin 33(1) i Kushtetutës, Dhoma i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së (për relevancën e jurisprudencës së GJEDNJ-së në interpretimin e një dispozite kushtetuese, shih paragrafët 45, 49 më sipër). Dhoma

vëren se, në çështjen *Kononov v. Latvia* [GC] dhe më së fundi, *Milanković v. Croatia*, GJEDNJ-ja konstatoi se “e drejta ndërkombëtare” në nenin 7(1) të Konventës i referohet gjithashtu DZN-së.¹¹⁹ Gjithashtu, sikurse konstatoi GJEDNJ-ja në *Kononov v. Latvia* [GC], ligjet ndërkombëtare dhe zakonet e luftës mund të jenë “të mjaftueshme në vetvete për të bazuar konstatimet për përgjegjësi penale individuale”.¹²⁰

76. Në të njëjtën kohë, nga jurisprudenca e GJEDNJ-së rrjedh se, që një normë e DZN-së e zbatuar në procedime penale të jetë në përputhje me nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës, ajo duhet të ketë një bazë mjaftueshmërisht të qartë për ta shpallur fajtor një individ. Dispozitat në fjalë kërkojnë që sjellja për të cilën shpallet fajtor një individ të përbënte, në kohën e kryerjes së saj, një veprë penale të përkufizuar me disponueshmëri dhe parashikueshmëri të mjaftueshme nga DZN-ja. Kjo rrjedh nga kushti që vepra penale në fjalë duhet të jetë e përkufizuar qartë në DZN, që përmbush kushtet cilësore të disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë.¹²¹

77. Sa i takon parashikueshmërisë, duhet theksuar se GJEDNJ-ja ka konstatuar që ajo përfshin një element të interpretimit gjyqësor, sepse gjithmonë do të ketë nevojë për qartësimin e pikave për të cilat ka dyshime. Nuk mund të interpretohet se neni 7 i Konventës e bën të paligjshëm qartësimin gradual të rregullave mbi përgjegjësinë penale përmes interpretimit gjyqësor nga çështja në çështje, me kusht që zhvillimi që rezulton të jetë në përputhje me thelbin e veprës penale dhe mund të parashikohej në mënyrë të arsyeshme.¹²²

¹¹⁹ ECtHR, *Kononov v. Latvia* [GC], cituar më lart, para. 186, 213, 227, 237, 244; *Milanković v. Croatia*, no. 33351/20, 20 January 2022, para. 52-66.

¹²⁰ ECtHR, *Kononov v. Latvia* [GC], cituar më lart, para. 237.

¹²¹ ECtHR, *Vasiliauskas v. Lithuania* [GC], cituar më lart, para. 154, 162, ku thuhet, ndër të tjera se “vepra penale duhet të jetë e përcaktuar qartë në legjislacion, qoftë në legjislacionin e vendit apo në atë ndërkombëtar [...]”; shih gjithashtu *Kononov v. Latvia* [GC], cituar më lart, para. 185, 187; *Korbely v. Hungary* [GC], cituar më lart, para. 70, 73.

¹²² ECtHR, *Kononov v. Latvia* [GC], cituar më lart, para. 185; për një vlerësim të përbashkët të disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë së përkufizimit të krimeve të luftës bazuar në ligjet ndërkombëtare dhe zakonet e luftës, që nuk ishin paraqitur në ndonjë botim zyrtar, shih para. 234-244;

78. Rrjedhimisht, zbatimi i drejtpërdrejtë nga DHS-ja i DZN-së në lidhje me krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, përfshirë format përkatëse të përgjegjesisë penale në bazë, në vërtetimin e fajësisë së një individi, është në përputhje me Kushtetutën, me kusht që ky zbatim të jetë në pajtim me nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës, sikurse është interpretuar nga GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj.

79. Në lidhje me këtë, Dhoma vëren se ky diskutim nuk synon të specifikojë në mënyrë shteruese të gjitha kushtet e zbatueshme sipas nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës, përfshirë edhe në lidhje me zbatimin e DZN-së më të favorshme, nëse ka, të hartuara pas kryerjes së pretenduar të veprës penale në fjalë. Sikurse nënvizohet më lart, vlerësimi i Dhomës ka të bëjë më tepër me pyetjen e përgjithshme nëse, si parim i përgjithshëm, zbatimi i drejtpërdrejtë nga DHS-ja i DZN-së në lidhje me krime lufte dhe krime kundër njerëzimit për vërtetimin e fajësisë së një individi, është në përputhje me Kushtetutën.

80. Dhoma vëren se parashtruesit janë ankuar edhe se, gjatë periudhës që përfshin Aktakuza, disa vepra penale dhe format përkatëse të përgjegjesisë penale nuk përbënin krime sipas DZN-së, ose se ato nuk kishin qenë të disponueshme ose të parashikueshme për ta (shih paragrafët 27, 30, 32 më lart). Në lidhje me këtë, Dhoma vëren se për pyetjen nëse sjellja konkrete e pretenduar përbënte vepër penale sipas DZN-së në kohën e kryerjes së saj, dhe për aspektet e tjera të ngritura nga parashtruesit, duhet të vendoset së pari gjatë procesit të gjykimit. E njëjta gjë vlen edhe për pyetjen nëse disa vepra penale konkrete janë të përfshira gjithashtu edhe në Ligj. Në këtë drejtim, Dhoma rikujton se u takon së pari paneleve të tjera të DHS-së që të vendosin, në përputhje me kompetencat e tyre, aspektet juridike dhe faktike që lidhen me çështjen gjyqësore që shqyrtojnë.

Korbely v. Hungary [GC], cituar më lart, para. 71; *Vasiliauskas v. Lithuania* [GC], cituar më lart, para. 155-157.

4. Përfundim

81. Duke pasur parasysh sa më lart, Dhoma konstaton se në kërkesën referuese të parashtruesit të dytë nuk zbulohet se duket se janë kryer shkelje sipas neneve 19 dhe 33(1) të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës, dhe nenit 15 të KNDCP-së për sa i përket pyetjes se, si parim i përgjithshëm, zbatimi i drejtpërdrejtë nga DHS-ja i DZN-së në lidhje me krime lufte dhe krime kundër njerëzimit për vërtetimin e fajësisë së një individi, nuk është në mospërputhje me Kushtetutën – me kusht që një zbatim i tillë të jetë në përputhje me nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës. Nga kjo rrjedh që, në këtë fazë të procesit, kjo pjesë e kërkesës referuese të parashtruesit të dytë duhet të deklarohet e papranueshme në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores.

VI. MOCIONET PËR BASHKIM ME KËRKESAT REFERUESE

82. Dhoma vëren se më 10 mars 2022, z. Thaçi dorëzoi dy mocione për bashkim, një me kërkesën referuese të parashtruesit të parë dhe tjetrin me kërkesën referuese të parashtruesit të dytë. Dhoma vëren se z. Thaçi nuk i dorëzoi këto mocione për bashkim për të plotësuar kërkesën e tij referuese në kuadër të çështjes KSC-CC-2022-15 të paraqitur për shqyrtim nga Dhoma, por në kuadër të kërkesave referuese të parashtruesve. Në këto mocione për bashkim, z. Thaçi parashtron se “pajtohet me argumentet e paraqitura në [dy kërkesat referuese] [...]”, dhe se ai “[...] u bashkohet [dy kërkesave referuese], dhe mbështet kërkesën për mjet juridik të paraqitur në to” (shih paragrafin 3 më lart). Në lidhje me këtë, Dhoma vëren së pari se as Ligji dhe as Rregullorja nuk parashohin mundësinë për t’iu “bashkuar” një kërkesë referuese të paraqitur nga një person tjetër. Duke qenë se rregulla 15(6) e Rregullores përcakton se Dhoma mund të urdhërojë “bashkimin e [...] referimeve”, kjo i jep mundësinë Dhomës mundësinë të shqyrtojë disa kërkesa referuese së bashku.

83. Dhoma vëren se, me dorëzimin e mocioneve për bashkim, z. Thaçi mund të ketë dashur të paraqesë, në emër të vet, pretendimet për shkelje të argumentuara nga

parashtruesit. Në lidhje me këtë, duhet rikujtuar se, në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit, dhe rregullës 20(1) të Rregullores, individët janë të autorizuar t'i parashtrojnë Dhomës kërkesë referuese në lidhje me shkelje të "të drejtave dhe lirive individuale" të garantuara në Kushtetutë. Gjithashtu, neni 58(1)(d),(e) i Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-15, përcakton se kërkesat referuese duhet të përmbajnë: (i) një deklaratë të shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutë; dhe (ii) një deklaratë që konfirmon përputhshmërinë me kriterin e shterimit të mjeteve juridike dhe të afatit për paraqitjen e kërkesës referuese.

84. Megjithatë, në këtë rast, z. Thaçi nuk ka specifikuar shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara me Kushtetutë ose elemente të tjera në pajtim me Udhëzuesin e Punës të përmendur më lart. Nëse z. Thaçi do të kishte dashur të paraqiste të njëjtat ankesa dhe argumente si parashtruesit, do të ngriheshin të njëjtat probleme lidhur me pranueshmërinë të diskutuara më lart në këtë vendim. Rrjedhimisht, sido që të jetë, ato do të kishin qenë të papranueshme për të njëjtat arsye të renditura më lart në këtë vendim. Për këtë arsye, mocionet për bashkim duhet të rrëzohen.

VII. KËRKESAT NË LIDHJE ME VENDIN E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS DHE PËR SEANCË

85. Në kërkesën e tij referuese, parashtruesi i dytë i kërkoi Dhomës që: (i) të mos caktojë vendin e zhvillimit të procedurës në shtetin pritës; dhe (ii) të caktojë datën për një seancë gojore.¹²³

¹²³ Kërkesa Referuese e Parashtruesit të Dytë, para. 89-90.

86. Lidhur me caktimin e vendit të zhvillimit të procedurave, Dhoma rikujton se, në bazë të nenit 3(8)(c) të Ligjit, për arsye të administrimit të duhur të drejtësisë dhe sigurisë, Kryegjykatësi i Dhomës, në bazë të kompetencës së tij diskrecionale, mund të kërkojë caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës. Në bazë të nenit 3(8)(d) të Ligjit, në rastin kur vendi i zhvillimit të procesit është caktuar të jetë në shtetin pritës, Kryetarja e DHS-së nxjerr një vendim administrativ për zhvendosjen e vendit të zhvillimit të procesit, ose të një pjese apo faze të tij, në shtetin pritës.

87. Më 18 janar 2019, Kryegjykatësja e Dhomës, në pajtim me nenin 3(8)(c) të Ligjit, paraqiti kërkesë për zhvillimin në shtetin pritës të të gjitha procedurave që burojnë nga kërkesat referuese që i paraqiten Dhomës në pajtim me nenin 49 të Ligjit, përveç nëse vendoset ndryshe. Kryegjykatësja argumentoi se kjo ishte e nevojshme për administrimin e duhur të drejtësisë.¹²⁴ Më 22 janar 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi vendin e zhvillimit të të gjitha procedurave para kësaj Dhome në shtetin pritës, përveç nëse vendoset ndryshe.¹²⁵ Dhoma konstaton se, për arsye të administrimit të duhur të drejtësisë, kërkesa e saj e mëparshme për ndryshimin e vendit të procedurës në shtetin pritës mbetet në fuqi edhe në lidhje me kërkesat referuese aktuale.

88. Sa i takon kërkesës së parashtruesit të dytë për caktimin e datës së një seance gojore, Dhoma rikujton se, në bazë të rregullës 15(4) së Rregullores, pas mbarimit të afateve për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim, Dhoma merr vendimin mbi bazën e parashtrimeve me shkrim, përveç nëse mbajtja e seancës është në interes të administrimit të duhur të drejtësisë. Dhoma mendon se mund të marrë vendim mbi kërkesat referuese bazuar në parashtrimet me shkrim dhe se zhvillimi i seancës nuk është i nevojshëm.

¹²⁴ KSC-CC-2019-06, F00001, Kërkesë për Ndryshimin e Vendit të Zhvillimit të Procedurës në lidhje me Referimet e Parashtruara në përfundim me Nenin 49 të Ligjit, publik, 18 janar 2019.

¹²⁵ KSC-CC-2019-06, F00002, Vendim për Vendin e Zhvillimit të Procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 janar 2019.

89. Bazuar në sa më lart, kërkesa e parashtruesit të dytë lidhur me ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës dhe për mbajtjen e një seance gojore duhet të rrëzohet.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, me vendim të njëzëshëm,

1. *Bashkon* shqyrtimin e kërkesës referuese të z. Jakup Krasniqi dhe të kërkesës referuese të z. Kadri Veseli;
2. *I shpall* kërkesat referuese të z. Jakup Krasniqi dhe z. Kadri Veseli të papranueshme;
3. *Rrëzon* mocionet e paraqitura nga z. Hashim Thaçi për t'iu bashkuar kërkesave referuese të z. Jakup Krasniqi dhe z. Kadri Veseli; dhe
4. *Rrëzon* kërkesat e z. Kadri Veseli për të mos caktuar vendin e zhvillimit të procedurës në shtetin pritës dhe për mbajtjen e një seance gojore.

/nënshkrimi/

Vidar Stensland
Kryegjykatës

Hartuar në anglishte, e hënë, 13 qershor 2022
Në Hagë, Holandë